



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë më 17.10.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në Liqenin e Shkodrës” (*komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Andrea Marto, Eglantina Gjermeni, Rakip Suli, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florion Mima, Endri Hasa, Lorenc Luka, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Agron Çela, Lefter Koka, Gjetan Gjetani dhe Rahman Rraja.

Të ftuar:

Silvana Dervishi – përfaqësuese nga Sektori i Marrëveshjeve në Ministrinë e Brendshme

Renata Balliu - Shefe e Sektorit në Drejtorinë Juridike, Policia e Shtetit

Ndue Doçi - Shef i Sektorit të Kufirit në Ministrinë e Brendshme

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Mirëmëngjesi, të nderuar deputetë!

Para se të kalojmë te rendi i ditës, a jeni dakord me procesverbalin e mbledhjes së kaluar?

Në rregull.

Sot në rendin e ditës kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në Liqenin e Shkodrës”. Relator për këtë marrëveshje është zoti Baraj.

Fjalën e ka zoti Baraj dhe më pas do të kalojmë në miratim.

Besnik Baraj – Faleminderit!

Sigurisht, moria e marrëveshjeve që janë bërë, veçanërisht me vendet fqinje, ka krijuar një lehtësi shumë të madhe në lëvizje, qoftë të pasagjerëve, qoftë edhe të mjeteve të ndryshme të transportit. Kjo marrëveshje e propozuar nga Mali i Zi ka pikërisht këtë qëllim dhe pala shqiptare e ka pranuar me kënaqësi.

Më pas, sipas edhe problemeve që mund të dalin gjatë aplikimit të kësaj marrëveshjeje, do të merren masat respektive nga ana e të dyja palëve. Një shqetësim që unë dua të ngre në këtë rast, është fakti se vihet re një mungesë përgjegjshmërie, veçanërisht në lidhje me mirëmbajtjen e mjedisit, kjo ndodh edhe me palën tonë, prandaj do t’ju thosha se në këtë drejtim duhen ngritur disa mekanizma që të kontrollojnë arsyet e ndotjes, të kontaminimit në zonën kufitare, në mënyrë që ato pamje të shëmtuara që ne i vëmë re herë-herë në zonat kufitare të përpiqemi që t’i shmangim dhe më pas kjo të shërbejë si model për t’u zbatuar edhe në vendet e tjera.

Për ligjin nuk kam ndonjë gjë për të komentuar. Më paska shpëtuar diçka, pika ku thuhet: “Hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, nuk ka informacion.

Eduard Shalsi – A ka ndonjë prej kolegëve ndonjë gjë?

Vullnet Sinaj – Do të mbikëqyret nga komisioni i përbashkët i Muriqanit. Kalimi në kufi do të jetë me kontrollin e njëres anë, jo të të dyja anëve, pra do të jetë i përbashkët.

(Diskutime pa mikrofon)

Po.

Malësia e Kajës...

(Ndërprerje incizimi)

Eduard Shalsi – Kush është dakord në parim me marrëveshjen? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Nesër do të bëjmë një mbledhje komisioni për një ndryshim neni, ndërkohë që të hënën dhe të martën që vjen nuk kemi mbledhje. Mund të kemi të mërkurën mbledhje.

Janë dy projektligje të sjella nga një deputet, është iniciativë deputeti. Ata që mbulojnë zona bujqësore e mira është t'i lexojnë. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Këtë do ta bëjmë të mërkurën që vjen.

Nesër gjatë seancës do të kemi mbledhjen e komisionit.

MBYLLET MBLEDHJA